



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqëndrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Vienna Insurance Group AG të shoqëria Interalbanian Sh.a

Në datën 28 Tetor 2010, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të kontratës së shitjes së aksioneve, të nënshkruar ndërmjet palëve (Vienna Insurance Group AG për blerësin dhe Interalbanian Sh.a për shitësin me objekt përfitim e kontrollit të shoqërisë Interalbanian Sh.a nga Vienna Insurance Group AG nëpërmjet transferimit të 75% +1 të aksioneve.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqëndrim është si vijon:

- Vienna Insurance Group AG: kryen menaxhimin strategjik dhe disa nga funksionet kryesore të grupit VIENNA INSURANCE GROUP duke përfshirë edhe infrastrukturën. Gjithashtu shoqëria kryen edhe aktivitetin e sigurimit të aksidenteve dhe të sigurimit të pronës si dhe aktivitet risigurimi në degët për të cilat ka marrë autorizim nga AMF-ja.;
- Interalbanian Sh.a: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimeve të jo-jetës bazuar mbi licencën nr. 9, datë 19.07.2004, lëshuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve (aktualisht AMF).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al